



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 21.05.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Nezir Çoçaj dhe Igor Simiq.

Munguan: Arben Gashi, Glauk Konjufca dhe Shkumbin Demaliaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardita Sylejmani, RTK; Donika Osmani - Ekonomia Online, Rabije Hyseni, praktikante-Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Fitore Sopjani, praktikante-Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Genc Nimani- Çohu, Anton Demhasaj- Çohu, Mejreme Tahirukaj Radio Kosova, Faton Fetahu dhe Ardian Bajraktari- MD, Bekim Kodraliu OSBE, Blerta Bejtullahu -EUSK, Abelard Tahiri MD, Valmira Saraçi - KTV, Ismail Shabani - Kosova Press dhe Alban Muriqi- QKRMT.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës, Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projekt-Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i Rendit të Ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projekt-Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074

Kryetarja paraqiti për shqyrtim projekt-kodin penal të Republikës së Kosovës dhe tha që se tashmë ka dy javë që Ministria e Drejtësisë e ka proceduar në Kuvend Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh që është dokument shumë i rëndësishëm e kam ftuar ministrin e Drejtësisë, Z. Tahiri, që të jetë i pranishëm në këtë takim, për të arsyetuar procedimin e këtij projekt-kodi dhe për ta njoftuar komisionin dhe të pranishmit për ndryshimet që i përmban ky projekt-kod dhe e ftoi ministrin që të marri fjalën.

Abelard Tahiri fillimisht e falënderoi komisionin për trajtimin me prioritet të Projekt-Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si një prej akteve legislative më të rëndësishme të Ministrisë së Drejtësisë. Procesi i hartimeve dhe ndryshimeve në Projekt-Kodin Penal, ka qenë një proces shumë transparent, profesional dhe gjithëpërfshirës. Për muaj të tërë përveç Institucioneve të fushës së drejtësisë kanë marrë pjesë edhe konzorcume të mëdha të shoqërisë civile, mediave, institucioneve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat në këtë proces kanë shqyrtuar dhe shkëmbyer ide për ndryshimin e mbi njëqind neneve të Kodit Penal. Ky Projekt-Kod është në harmoni të plotë me standardet e Bashkimit Evropian duke shënuar kështu një avancim në reformën për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Kanë qenë tri parime themelore që na kanë ndikuar në punën e hartimit të këtyre ndryshimeve. E para, përcaktimi i qartë për sundim të ligjit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. E dyta, fleksibiliteti më i madh në punën e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit dhe e treta, mbrojtja, promovimi dhe avancimi i nocioneve të të drejtave të njeriut.

Këto ndryshime dhe kjo qasje, mund të them me krenari se do të afrojë një Kod Penal të bazuar ekskluzivisht në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, barazisë para ligjit, si dhe drejtësisë kuptimplotë dhe të pa alternativ në rastet e caktimit të fajësisë dhe shqiptimit të dënimit. Kompletimi i këtij kodi, si dhe punës që është duke u bërë në plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, të cilën po ashtu shumë shpejt do ta kemi gati, paraqesin hap jashtëzakonisht të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit të drejtësisë. Kjo mundëson punë efikase në zbatimin rigoroz të standardeve të drejtësisë, si dhe intensifikimin e përpjekjeve tona, si institucioneve në një dimension tërësisht të ri. Përveç që siguron sundim efikas të ligjit për qytetarët tanë, forcon dhe garanton perspektivën Evropiane të Republikës së Kosovës.

Segmentet kryesore të rishikuara në Kodin Penal janë si vijon: në veprat që hyjnë në kuadër të krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë rishikuar dhe hartuar nëntëmbëdhjetë nene, për të mundësuar kështu ndjekje efektive të aktiviteteve kriminale që ndodhin në kontekst të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këto nene mbulojnë një sërë aktiviteteve nga kontrabandimi e deri te mashtrimi dhe prodhimi i produkteve të dëmshme, si dhe përcaktimi në vepra penale të korrupsionit, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, marrjen dhe dhënien e ryshfetit, mashtrimin në detyrë e tjera, duke i dhënë një përgjigje të fuqishme kërkesave për parandalim të veprave korruptuara në nivel të ushtrimit të detyrës zyrtare.

Ndryshimet, po ashtu, kanë rritur afatet e parashkrimit për këto vepra duke afuar kështu një avancim dhe vendosmëri për të afuar zgjidhje për këto probleme që shpesh herë me të drejtë kanë

qenë subjekt i kritikës. Kjo ju jep më shumë kohë gjykatave për të përfunduar rastet që kanë të bëjnë më krim të organizuar dhe korrupsion. Po ashtu në kuadër të përmbushjes dhe të agjendës së reformave evropiane, ku është rekomanduar hartimi i politikës së suspendimit të zyrtarëve publik, në rast të ngritjes së aktakuzës për korrupsion, ne kemi hartuar një koncept dokument të rekomandimit që janë përfshirë në kod. Pra, janë propozuar amendamentet e reja që i ndalojnë personit zyrtar ushtrimin e funksionit në Administratë Publike apo në Shërbim Publik deri në dhjetë vite nga aktgjykimi dënues. Kjo dispozitë parasheh që kur zyrtari publik dënohet për veprë penale të korrupsionit, atij i ndalohet ushtrimi i funksionit në shërbim publik deri në dhjetë vite. Ndërkaq dënimet për vepra penale që ndërlidhen me korrupsion, kudo që ka pasur mundësi janë rritur dhe janë bërë komulative në vend alternative. Këto masa janë përkushtim i yni për të mbrojtur integritetin e institucioneve tona për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në vazhdimësi. Po ashtu tha se sa i përket konfiskimit të pasurisë të përfituar me veprë penale, si dhe përcaktimit të mëtejme të politikës sonë legislative ka pasur një konsultim të vazhdueshëm ndërinstucional, si dhe me partnerët tonë zhvillimor. Pra, kjo çështje do të jetë subjekt i trajtimit në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për kompetencat e zgjeruara të cilat janë në përfundim e sipër.

Në kodin penal ka ndryshime konkrete që ndërlidhen me aspektet e shmangies nga pagesa e tatimit, tarifave të detyrueshme doganore, veprave penale në lidhje me produktet në akcizë, veprat penale të pastrimit të parave, vepra penale për keqpërdorim të subvencioneve dhe donacioneve. Kjo do t'i jap një dimension tjetër përpjekjeve institucionale që ndërlidhen me to. Sa i përket të drejtave të njeriut, ndryshimet e reja parashohin nene për krime të urrejtjes dhe dënime specifike të ngritura për vepra që janë të motivuara nga urrejtja ndaj grupeve të caktuara. Gjithashtu janë hartuar nene të reja që trajtojnë mbrojtjen e grave dhe dhunën brenda marrëdhënies familjare, si dhe kundër ngacmimit seksual. Po ashtu, janë rritur edhe dënimet për kryesit e veprave të përfshirë në vepra penale të trafikimit me njerëz për shfrytëzim seksual dhe janë rritur dënimet për veprat penale kundër fëmijëve. Pra, veprat që ndërlidhen me parandalimin e terrorizmit, ku mbi njëzet nene që kanë të bëjnë me terrorizëm janë shtuar duke qenë në pajtim me direktivat e fundit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare që ndërlidhen me fushën e financimit, në mënyrë që të spastrojë rrugën e atyre që janë përfshirë në ato aktivitete. Konsideroj që ky akt me të gjitha analizat, komentet, gjithë përfshirjen dhe transparencat që e kanë karakterizuar, paraqet draftin e konsoliduar që në njërin anë adreson më shumë probleme konkrete me të cilat përballet shoqëria jonë siç është korrupsioni apo krimi i organizuar, ndërsa në anën tjetër shënon një progres të lartë në sistemin tonë të drejtësisë. Në fund kërkoi, që brenda komisionit të vendoset prioritet shqyrtimi i projekt-kodit të Republikës së Kosovës, i cili përveç se do të përmbushë kërkesën e BE-së për fuqizimin e luftës kundër korrupsionit si dhe nevojat e institucioneve të zbatimit të ligjit, përparimet e qarta dhe siguri juridike për qytetarët tanë, reflekton drejtpërdrejt në procesin e liberalizimit të vizave.

Kryetarja tha se kemi diskutuar shumë lidhur me institucionet kundër korrupsionit, pra që luftojnë korrupsionin. Ne vazhdojmë të kemi shumë institucione qoftë agjenci, qoftë brenda policisë, prokurori, që merren me luftën ndaj korrupsionit, por në anën tjetër nuk kemi rezultate konkrete. Shpesh e kam theksuar faktin që është e rëndësishme që të kemi një institucion të veçantë që do të merret vetëm me luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, me theks të veçantë të krijohet një departament në gjykatë që do merret me rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, por po ashtu gjyqtarë dhe prokurorë të profilizuar edhe pse ne tashmë kemi gjykatë speciale, por jo në territorin tonë dhe jo brenda sistemit tonë të drejtësisë. Në raportin vlerësues të Bashkimit Evropian theksohet që ka mungesë profesionalizmi të shumë gjyqtarëve dhe prokurorëve, në rastet e korrupsionit. Pra, edhe sot përballem me mungesë kapacitetesh dhe profesionalizmi për t'i trajtuar

këto raste ku shpesh përfundojnë pa aktgjykim dënues. Sa i përket rasteve të parashkrimit, këtu është zgjatur parashkrimi me sa kam parë, por konsideroj që duke marrë parasysh faktin që shumë raste të korrupsionit janë parashkruar, herë qëllimisht dhe herë jo, por në të shumtën e rasteve me qëllim, përse nuk keni menduar që rastet e korrupsionit të mos parashkruhen, ndoshta kjo do t'i ndihmonte edhe më shumë luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ka disa nene që i bëjnë më të dallueshme kategoritë e ndjeshme, pra janë bërë ndryshime më të mira, por ka pasur edhe kërkesa tjera që dhuna ndaj grave të jetë nen i veçantë në Projekt-Kodin Penal dhe pyet se a ka pasur propozime që të jetë nen i veçantë apo kapitull i veçantë dhuna ndaj grave? Po ashtu tha se ka vënë re se në këtë Projekt-Kod nuk janë të përfshira veprat penale kundër shërbimeve komunale apo keni konsideruar që është përfshirë në nenet e tjera dhe nuk ka qenë e nevojshme që të ketë kapitull të veçantë? Gjithashtu në nenet sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore ka një avancim prej Kodit aktual. Në bazë të shkresës suaj thuhet se duhet të përshejtohen procedurat për trajtimin e projekt- Kodit, por për Komisionin për Legjislacion është shumë ngarkesë që një Kod kaq i rëndësishëm të trajtohet në një kohë tepër të shkurtër. Në fund znj. Haxhiu pyet se a është kusht për liberalizimin e vizave miratimi e këtij Projekt- Kodi Penal.

Hajdar Beqa tha se Ministria e Drejtësisë është duke bërë një punë dinamike, në veçanti në infrastrukturën ligjore duke pohuar se duhet ta luftojmë korrupsionin dhe krimin e organizuar, si pika të zeza që kanë qenë nëse i marrin e raportit e progresit edhe në të kaluarën. Në fakt Kodi Penal edhe nëse nuk është i lidhur direkt me liberalizimin e vizave, ka të bëjë me atë se prej njëqind neneve të ndryshuara, nëntëmbëdhjetë nene e kanë trajtuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Pra, i ka dhënë prioritet krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sa i përket rritjes së afateve të parashkrimit, tha se është një hap i mirë që e ka bërë ministria për arsye se duhet me pas një afat, por në të njëjtën kohë mendoj që Gjykata duhet të ketë një agjendë dinamike, që mos t'i vonojë lëndët në procesin e shqyrtimit. Duhet ta keni parasysh edhe prezumimin e pafajësisë sepse ne nuk mund të dalim jashtë Kushtetutës, por megjithatë është hap pozitiv që personat të cilët janë të dënuar me krim edhe korrupsion, dhjetë vite nuk kanë të drejtë të ushtrojnë funksionin e tyre. Po ashtu edhe te konfiskimi i pasurisë i përfituar me vepër penale mendoj që është një hap shumë i mirë. Gjithashtu edhe shmangia nga tatimi, taksa, dogana që lidhen dhe me ato komunale është një hap i rëndësishëm se ne vetëm në këtë formë mund ta kemi një shtet të fortë dhe buxhet të fortë duke e luftuar ekonominë in formale. Në fund tha ky kod është i avancuar në gjitha fushat me theks të veçantë te dhuna ndaj familjes duke pohuar se është i rëndësishëm së veçantë, ndaj duhet të që jetë sa më shpejt në fuqi.

Kryetarja theksoi se pasi që Qeveria e ka proceduar këtë projekt-kod në Kuvend, është thënë që parashihet një dispozitë që zyrtarët që kanë aktakuza për korrupsion të suspendohen nga detyra. Kjo nuk qëndron për arsye se vendin e ka në Kodin e Procedurës Penale dhe jo në Kodin Penal.

Bilall Sherifi tha se ndryshimet e bëra janë shumë për t'u shqyrtuar në një periudhë kaq të shkurtër kohore, por po e përsëris pyetjen që e shtroj Z. Beqa se a është e shkruar në mënyrë taksative që është kusht për liberalizimin e vizave apo është si sugjerim që është mirë të kalohet me qëllim që lufta kundër dukurive negative të jetë më efektive.

Igor Simiq- tha se më vjen mirë që je sot këtu me ne ku kam disa pyetje që janë me interes kyç për funksionimin normal, jo vetëm të ministrisë, por edhe për sundimin e ligjit në Kosovë. Ndërkaq tha se Kodi Penal ekzistues i Kosovës, pas analizës nga ana e shqiptarëve që kanë studiuar

albanologjinë dhe e njohin gjuhën serbe, janë gjetur 2000 gabime terminologjike, 2100 gabime gramatikore dhe 1300 gabime drejtshkrimore. I nderuar ministër paramendoni situatën në të cilën dikush është i akuzuar apo dëshmitarë në ndonjë proces dhe kemi versione të ndryshme në gjuhën shqipe dhe atë serbe të Kodit Penal, kjo i jep shumë liri prokurorëve, gjyqtarëve dhe palëve në procedurë kur vendoset për disa çështje. Po ashtu kur u zhvendos gjykata nga Mitrovica në Vushtrri ka pasur raste kur është zhvilluar procesi gjyqësor dhe pala në proces ka qenë e nacionalitetit tjetër dhe nuk ka pasur përkthim të siguar. Ndërkaq njerëzit kanë pritur përfundimin e gjykimit dhe nëse ju kanë vendosur prangat e kanë ditur që janë shpallur fajtor dhe nëse nuk ju kanë vendosur prangat ata e kanë kuptuar që janë të lirë duke përmendur edhe disa shembuj që kanë ndodhur për shkak të mos kuptimit të gjuhës, ngase nuk ka pasur përkthyes në gjykatë. Gjithashtu kërkoi që kur është në pyetje Kodi Penal të bëhet një lekturë, që kodi të jetë i përkthyer në mënyrë kualitative dhe mos të vijmë në një situatë që të paraqesim 500 amendamente dhe dikush të thotë që deputetët serbë po e bllokojnë miratimin e Kodit Penal. Ne kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe ata mund të thonë se si po e votoni një se si po e votoni një kod të tillë dhe i bie që ne me qëllim po marrim pjesë në shkelje. Integrimi i gjyqësorit në veri është duke u zhvilluar dhe po ballafaqohet me mungesë të përkthyesve, ku gjithsej janë 5 përkthyesë të cilët duhet të përkthejnë më shumë se 20 mijë lëndë, e cila nuk është e drejtë. Në fund kërkoi që të miratohet ndonjë akt për të mundësuar, që besoj se edhe kolegët deputet do ta përkrahin me qëllim që të sigurohen mjetet për funksionimin normal të sistemit gjyqësor.

Sami Kurteshi tha se mungon një analizë e brendshme e krejt tekstit, sidomos e gjuhës së përdorur duke pohuar se disa gjëra gjuhësisht vërtet janë problematike, ndaj norma duhet të jetë e saktë dhe e qartë. Tha se kemi përdorim të koncepteve jo kushtetuese duke marrë shembull nënin 5 ku thotë: "Që kryesit të veprës penale mund t'i mohohen ose kufizohen të drejtat e caktuara", pra sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk mohohet e drejta, ajo kufizohet. Ndërsa te definimi i veprës penale kishte interes të dinte se a është përkthim apo formulim sepse mendonte që ma tepër është përkthim. Sipas tij definimi i veprës penale duhet ta ketë një karakter, duhet t'i ketë kategoritë, të përcaktohen cilat janë ato kategori, si ndahen, cilat kritere duhet t'i plotësojnë. Gjithashtu hartimi i këtij ligji nuk është shumë profesional. Po ashtu pyet se a është dashur vetëm këto çështje të ndryshohen apo ka edhe çështje tjera? Ndërkaq një paraqitje krahasimore me vendet tjera do të ishte shumë e rëndësishme. Në fund pasi pati vërejtje teknike, gjuhësore dhe përmbajtjesore propozoi që të rishikohet edhe njëherë me kujdes Projekt-Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Korab Sejdiu tha se duke pasur parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij ligji për shoqërinë tonë, besoj që barrë e jona është të gjejmë një balancë të procedimit të shpejtë, por pa e sakrifikuar në asnjë mënyrë cilësinë e këtij ligji. Ndërkaq tha se është me rëndësi të madhe dhe do të na e lehtësonin shumë punën nëse problemet teknike në ligje do të eliminohen duke pasur parasysh mundësitë shumë më të larta që i keni ju si ministri.

Kryetarja tha se do ta përkrahë këtë projekt-kod edhe në komision, por edhe në seancë, ndonëse prapë mendoj se edhe në qoftë se ky do të hynte në fuqi, sërish do të përballemi me krim të organizuar dhe korrupsion, duke pohuar se pa e pasur Kosova Ligjin për Anti-mafia apo ligjin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme nuk do të mund të bëjmë veprime konkrete ose nuk do të mund të dukemi si shtet që lufton krimin e organizuar. Ndërkaq edhe Grupi Parlamentar e ka

proceduar Projekt-ligjin për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme dhe kërkoi që ta mbështesin këtë nismë, ashtu sikurse ju pa kërkoni për t'i mbështetur projektligjet.

Abelard Tahiri- Në lidhje me pyetjen që e ngriti z. Kurteshi, tha se ndryshimet e theksuara nuk kanë qenë pjesë e ndryshimeve fare, por kanë qenë ashtu siç janë në ligjin aktual. Ndërsa rreth çështjes që e ngriti znj. Haxhiu rreth gjykatës speciale ose panelit të specializuar, tha se janë duke e trajtuar këtë çështje në kuadër të rishikimit funksional dhe se e shohin më se të nevojshme që Kosova ta ketë një panel të specializuar të gjyqtarëve ose një gjykatë speciale e cila do t'i trajtonte lëndët që vijnë nga prokuroria speciale.

Po ashtu tha se gjë të tillë jemi duke e trajtuar me Këshillin Gjyqësor dhe gjatë këtij viti do të vijmë më një qëndrim se si do ta trajtojmë këtë çështje ma tutje. Në lidhje me pyetjen se a është kërkesë e Bashkimit Evropian dhe a ndërlihet me vizat ky projekt-kod penal që ne e kemi sjellë sot tha se po nenet që ndërlihen me luftën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, pra ato që i theksuan më lart, janë direkt kërkesë e Bashkimit Evropian dhe ndërlihen me procesin e liberalizimit të vizave. Po ashtu theksoi se gjatë muajit maj do ta dërgojmë projektligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit, ndërsa në fund të muajit qershor do ta dërgojmë Projekt-Kodin e Procedurës Penale duke pohuara se është mirë të bashkëpunohet edhe me zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndaj këto janë afatet që ne si Qeveri e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi duhet t'i përmbushim. Më tej shtoi se e kuptoj që duhet më tepër kohë për t'i shqyrtuar këto projektligje, por kërkoj konsideratë të lartë, për shkak procesit që jemi në raport me liberalizimin e vizave, që të trajtohet me prioritet Projekt-Kodi Penal dhe mos të jetë pengesë në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët tanë. Ndërsa sa i përket përkthimeve tha se kanë problem të madh me çështjen e përkthimit sepse kanë mungesë të përkthyesve sidomos në gjuhën serbe. Theksoi se kemi shërbime të kontraktuara nga jashtë, por gjithmonë ndodhin gabime të tilla. Por ne gjithmonë jemi angazhuar që të bëjmë më të mirën e mundshme, por gjithmonë kemi hasur në vështirësi të tilla duke theksuar edhe problemin në Gjykatën e Mitrovicës që edhe atje kanë hasur probleme me përkthim, megjithëse kjo i përket Këshillit Gjyqësor të Kosovës, por jam munduar që me mjete financiare t'i ndihmojmë kësaj Gjykate që të angazhojnë përkthyes shtesë për qytetarët që ballafaqohen nëpër procese gjyqësore. Sa i përket koncept dokumentit për suspendim, ajo do të jetë në Projektin e Kodit të Procedurës Penale.

Sami Kurteshi tha se sa i përket përkthimit mendoj se cilësia dhe sasia e përkthimeve sidomos shqip-serbisht është duke rënë. Përkthimi nga gjuha serbe në gjuhën shqipe do duhej të bëhej nga një person që gjuhën e nënës e ka gjuhën serbe, por që e njeh shumë mirë gjuhën shqipe. Është e rëndësishme që të ketë përkthyes profesionist duke ditur që ky projektligj ka rëndësi të madhe.

Abelard Tahiri tha se sa i përket dhunën ndaj grave është neni 248 që trajton dhunë në familje. Tha se ishte i hapur për bashkëpunim në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e këtij projektligji. E rëndësishme është se ndryshimet që janë bërë në nenet që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit që ndërlihen me liberalizimin e vizave, ato të trajtohen ashtu siç janë dhe të kalojnë sa më shpejt. Ndërkaq tha se është bërë një avancim dhe ne kemi qenë të kujdesshëm që të mos bie ndesh me të drejtat e njeriut sa i përket këtyre ndryshimeve dhe është bërë maksimumi i mundshëm i parashkrimit i veprave penale. Ka qenë përkushtim i imi prej fillimit që sa ma shumë që të jetë e mundur për shkak të kapacitetit jo të mjaftueshëm edhe të gjyqësorit edhe të prokurorisë, të zgjatet parashkrimi i veprave të tilla në mënyrë që mos të parashkruhen vepra të tilla. Përpos Gjykatës së Prishtinës që ka një numër shumë të ngarkuar të

lëndëve e kemi edhe Gjykatën Themelore të Prizrenit tash dy vjet nuk ka asnjë parashkrim të asnjë lëndë dhe ky është një sukses i madh. Besoj se edhe me rritjen e numrit të gjyqtarëve do të ndikojë një gjë e tillë edhe në Gjykatën Themelore të Prishtinës, që sa më pak ose fare të mos kemi parashkrime të lëndëve, sidomos për ato që ndërlidhen me vepra penale dhe keqpërdorime të parasë publike.

Bilall Sherifi tha se kur e kemi parasysh të gjitha këto vështirësi dhe shpeshherë na vjen ndonjë material aq konfuz dhe pastaj nuk kemi kohë të mjaftueshme për t'i bërë këto ndryshime, jo se na duhet shumë kohë për të ditur se a na nevojiten këto ndryshime, por problemi është se janë duke ardhur projektligjet me shumë gabime. Pra, kërkohet që t'i eliminoni këto mangësi në mënyrë që pastaj deputetët të mos kërkojnë më shumë për të trajtuar ligjet të cilat janë të rëndësishme në procesin e përmirësimit të legjisllacionit ngase shpeshherë grupet e punës kthehen në grupe hartuese.

Abelard Tahiri sqaroi se përveç drejtimit nga Ministria e Drejtësisë tha se në këtë punë kanë qenë të angazhuar gjashtëdhjetë ekspertë ku grupi kryesor kanë qenë i përbërë nga tridhjetë ekspertë, nga Këshilli Gjyqësor, nga Këshilli Prokurorial, nga institucione të ndryshme financiare, nga Inteligjenca Financiare, Avokati i Popullit, Organizatat e shoqërisë civile, nivele të ndryshme të gjyqtarëve. Pra, ka qenë një grup i madh që kanë punuar nga të gjitha mekanizmat që të arrijmë të përpilojmë mirë këto ndryshime që sot janë para jush. Ky projekt-kod është përfunduar në muajin janar, por kemi pritur nga Komisioni Evropian që të na japin dritën e gjelbër, që të procedojmë më tutje duke thënë se ka marrë kohë përkthimi pastaj në gjuhën serbe. Por përkthimi në gjuhën serbe vazhdon me qenë problem i madh për Ministrinë e Drejtësisë, ku theksoi së është bërë një punë e mirë edhe në bashkëpunim me ekspert të Komisionit Evropian.

Sami Kurteshi tha se mos të zgjatet puna edhe në Komision i propozoi ministrin që ky projekt-Kod të kthehet prapë në ministri për aq kohë sa të jetë e nevojshme deri në një javë apo dy javë, me arsye që të rregullohen ato problemet teknike që kishte, si ato gjuhësore, të përkthimeve dhe përmbajtjesore. Theksoi se deputetët i kanë kapacitetet shumë më të kufizuara se ministria dhe do zgjaste puna shumë më shumë në komision, sepse do të detyroheshim pastaj të bënim shumë amendamente.

Abelard Tahiri tha se kishte marrë një shkresë nga Avokati i Popullit, me sugjerime për afatet optimale për draftimin e një projektligji të cilat janë nga 16-36 muaj, që i duhen Ministrisë së Drejtësisë, por për shkak të agjendës së reformave Evropiane dhe për shkak të angazhimit të tyre në përmbushjen e kriterëve dhe për shkak të vonesave që i kishin shkaktuar tash e disa vite, theksoi se angazhimi i tyre ishte i madh që në vitin 2018 të arrijmë t'i përmbushim kërkesat dhe kriteret që na kërkon Bashkimi Evropian. Ndërkaq tha se mund të ndodhin gabime të tilla, por ajo që është esenciale është që ne po bëjmë ngritje në këtë drejtim. Në fund kërkoi mirëkuptimin dhe përkrahjen e komisionit.

Igor Simiq tha se qëllimi im është i mirë, por më duket se nuk është kuptuar sepse kur të miratohet Projekt-Kodi Penal në Kuvend të gjithë qytetarët do të jenë të drejtuar nga ne dhe të gjitha gabimet që janë përmendur janë madhore. Po ashtu tha se e kuptoj urgjencën për vënien në rend dite për miratimin e këtij kodi dhe sa është interesi i përgjithshëm lidhur me liberalizimin e vizave, por

edhe atyre njerëzve që mbasin të jetojnë në Kosovë kanë nevojë për ligje të mirëfillta. Ne nuk mund të ndryshojmë Kodin çdo gjashtë muaj dhe pres nga ministri dhe ekipi i tij që është vërtet e nevojshme të ndryshohet Kodi të bëhet në mënyrë kualitative dhe jo nesër të mos shikojmë qytetarët në sy se çfarë ligji kemi miratuar. Nëse Bashkimi Evropian dëshiron të kontribuojë, profesionistët e tyre le të kyçen në proces në mënyrë më aktive e jo të bëjnë presion, sepse kur të miratohet ligji, i cili është i keq, do të thonë që nuk ka sundim të ligjit në Kosovë, ligjet janë të këqija dhe prapë përgjegjësia do të bie mbi ne. Në fund propozoi që të merren parasysh këto vërejtje para se të vendosni të votoni.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë votash 6 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projekt-Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu